



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:088404

Datë: 07.07.2022

Numri i dokumentit: 03210269

**P.Nr.123/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: L.B., për shkak të veprës penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.4, të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 774/2021, (2021:0030819), të datës 02.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 27.06.2022, në praninë e prokurores së shtetit Jelena Marjanovic, të dëmtuarit K.H., të akuzuarit L.B. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit, Av. Skënder Musa, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa më datë 07.07.2022, e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

L.B., nga i ati G., e ëma K., e vajzërisë H., “data e lindjes”..., në Skenderaj, ndërsa tani me vendbanim në Fushë Kosovë, me nr. personal:..., i pa punë, i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës;

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

Me datën 08.05.2021, rreth orës 03:00 h, pas mesnatës, patrulla e policisë në Skenderaj 100/2, në përbërje prej D.D. #10632, K.H. #10546 dhe Arsim Misimi #5089, e kanë arrestuar të dyshuarin L.B., në hapësirat e policisë, pas ankesës nga ana e motrës së tij, G.B., për shkak të një mosmarrëveshje në familje, i njëjti ka ndërmarrë veprime të pakontrolluara në drejtim të policisë, duke e refuzuar arrestimin, në këtë rast i dëmtuari K.H. pëson lëndime – gërvishnje të gishtit tregues të dorës së djathtë dhe në bazë të raportit mjekësor i njëjti pëson lëndime trupore,

Me këtë ka kryer veprën penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.4, të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70 e 401, të KPRK-së, dhe nenit 359, 365, 450, 463 të KPP-së, e:

## G J Y K O N

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Gjykata, në bazë të nenit 44, të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve ia zëvendëson me dënim me gjobë, ashtu që:

2. Obligohet i akuzuari që të paguajë gjobën në shumën prej 1500 € (një mijë e pesëqind euro), të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK - së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga data 08.05.2021 deri me datë 21.06.2021.
4. Obligohen i pandehuri, që t'i paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 774/2021, (2021:0030819), të datës 02.06.2021, kundër të pandehurit L.B., për shkak të veprës penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.4, të KPRK-së.

Gjykata e ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, më datë 27.06.2022, në prani të prokurores së shtetit Jelena Marjanovic, të dëmtuarit K.H., të akuzuarit L.B. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit Av. Skënder Musa, ku pas leximit të aktakuzës dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga gjykata për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë. Ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërsi fjalën e mbrojtësit të tij duke i kërkuar falje të dëmtuarit po ashtu edhe organeve të rendit që janë marr me këtë rast, duke shprehur pendim të thellë e lusë gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të butë, pasi që asgjë të keqe nuk kam pasur, nuk kam e as që do të kem në të ardhmen me të dëmtuarin K.H..

Prokurorja e shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se në bazë të nenit 248, të KPP – së, janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor. Ndërsa, në fjalën përfundimtare, theksoi se gjatë shqyrtimit gjyqësor është konstatuar se i pandehuri është fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, kjo është

vërtetuar edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e tij, andaj i propozojë gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe me rastin e caktimit të dënimit të marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I dëmtuari, K.H. sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se le të mbetet në vlerësimin e gjykatës, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtohet me mendimin e prokurores së shtetit dhe me secilin vendim që do ta marr gjykata në këtë rast.

Mbrojtësi i të pandehurit L.B., Av. Skënder Musa në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pranimi është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, pranimi është vullnetar, pas konsultimeve me mua si mbrojtës, i pandehuri i ka pranuar benifitet e pranimit të fajësisë, po ashtu e ka të qartë se do të shpallet fajtor dhe do të dënohet, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Në fjalën përfundimtare theksoi se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë dhe i vjen keq për rastin e ndodhur, pasi ka qenë i dehur dhe asnjë veprim nuk e ka ndërmar me dashje, duke i propozuar gjykatës që gjatë matjes së dënimit në kuptim të nenit 69, të marr parasysh si rrethana lehtësuese sjelljet e mëparshme të kryerësit të veprës penale dhe sjelljet pas kryerjes së veprës penale, duke konsideruar se janë plotësuar kushtet që gjykata të zbatoi nenin 71, par.1, nëpar.1.2, pasi ekzistojnë rrethana lehtësuese për të shqiptuar një dënim sa më të butë, si dënimi me burg me mundësinë për zëvendësimin e tij me dënim me gjobë. I mbrojturi im nuk është person problematik, është pronar i dy bizneseve, ka të punësuar dhe dënimi eventual i tij me burgim efektiv do të shkaktojë dëme të pariparueshme në bizneset e tij.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248, të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet edhe në provat me të cilat disponon kjo gjykatë, si: Deklarata e të pandehurit L.B., e dhënë në polici me datë 22.05.2021; Deklarata e dëshmitarit D.D., e dhënë në polici me datë 26.05.2021; Deklarata e të dëmtuarit K.H., e dhënë në polici me datë 26.05.2021; Raporti i policit, i datës 08.05.2021; Deklarata e dëshmitares G.B., e dhënë në polici me datë 08.05.2021; Deklarata e të pandehurit L.B., e dhënë në polici me datë 08.05.2021; Deklarata e dëshmitarit S.B., e dhënë në polici me datë 08.05.2021; Raportet mjekësore të datës 08.05.2021; Një fotografi e lëndimeve të të dëmtuarit K.H.; Fotografitë e vendit të ngjarjes, gjithsejtë 5 fotografi; Raporti i alkool testit, gjithsejtë 4 fotografi. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401, par.4, të KPRK – së. e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-ës. Rrethana rënduese në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, faktin se i njëjti i ka kërkuar falje të dëmtuarit, faktin se vepra penale është kryer nën ndikimin e alkoolit, faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se nuk dyshohet për ndonjë veprë tjetër penale, rrethanat personale të pandehurit duke qenë i moshës së re, çka për gjykatën më lehtë mund të bien nën ndikimin e rrethanave të rastit.

Gjykata ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim burgim, ku me pëlqimin e të pandehurit dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 muajsh, në kuptim të nenit 44, të KPRK-së, ia zëvendësoj me dënim me gjobë, duke e obliguar të njëjtin ta paguaj shumën prej 1500 € (një mijë e pesëqind euro), duke qenë se janë plotësuar kushtet për një zëvendësim të tillë dhe se gjykata është e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg i cili u zëvendësua me dënim me gjobë, ndaj të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450, par. 2, pika 2.1 dhe 2.6, të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39, par.3, të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv, ngase në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pala e dëmtuar ka deklaruar nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 359, 365, 450, 453, të KPPK-ës nga arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.Nr. 123/2021, datë 06.07.2022**  
**2021:088404, 07.07.2022**

Zyrtare ligjore:  
Atdhetare Bashota Krasniqi

**Gjyqtari**

**Rrahman BEQIRI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.